

=====

Ndikimi i faktorëve të mjedisit biznesor në vlerën e investimeve të huaja në Kosovë

Emin Neziraj

Fakulteti i Biznesit, emin_neziraj@yahoo.com

Abstract

In this paper are discussed the problems of foreign investment and factors which can influence on effect of the value of investments in Kosovo.

Therefore, theoretical model is based on theoretical approach with the topics, which are closed with phenomenon of investment from the macroeconomic aspect. In the second part of this paper is presented the analysis of the factors which influencing to investment by using the technique of descriptive statistics of market conditions and business environments where is find found the problem of great level of low foreign investments in Kosovo caused by noneconomic stability and lack of implementation of laws.

Key words: foreign direct investment, investment accumulation, business environment

Abstrakti

Në këtë punim trajtohet problematika e investimeve të huaja dhe faktorët të cilët ndikojnë në kryerjen e investimeve dhe përcaktojnë vlerën e tyre në Kosovë. Prandaj, modeli teorik është bazuar në diskutimin e fenomenit të investimeve nga aspekti makroekonomik. Në pjesën dytë është bërë analiza për faktorët të cilët ndikojnë në investime duke përdorur tekniken e statistikës përshkruese të frekuencës për kushteve të tregut dhe mjediset e biznesit dhe është konstatuar se problemi se shkak i nivelit të ulët të investimeve të huaja në Kosovë është jo stabiliteti ekonomik dhe mungesa e zbatimit të ligjeve.

Fjalë kyçe: Investimet e huaja direkte, akullimi i investimeve, mjedisi biznesor

Hyrje

Diskutimi i problemit

Në të gjitha shtetet në zhvillim, si dhe shtetet të cilat janë në nivelin e hershëm të zhvillimit ekonomik, siç është Kosova investimet e huaja shihen si një

=====

burim rëndësishëm i zhvillimit ekonomik. Po ashtu, këto shtete të cilat ekonominë e zhvillojnë duke bazuar në investimet e huaja japin kontribut politik dhe ekonomik në krijimin e sinjalit pozitiv për vende të tjera të cilat ende nuk kanë platformën ligjore dhe modelin e akumulimit të investimeve të huaja.

Një prej roleve të investimeve të huaja është krijimi i industrive të reja dhe zhvillimi i atyre ekzistuese në një konkurrencë plotësisht të hapur, gjë që përbën sfidë sidomos për shtetet në zhvillim, dhe në veçanti për ato shtete të cilat kanë zhvillim ekonomik të ulët siç është Kosova (Raport Progresi i EU-së për Kosovën, 2015)..

Në rastin e Kosovës, pas kolapsit të industrive të kohës së komunizmit apo sistemit social bazuar në sistemin socialist, vendi në thelb po kalon nëpër një fazë të ri-industrializimit, të prirë nga sektori privat. Në këtë drejtim, tërheqja e investimeve të huaja direkte (IHD) apo lindja e kompanive vendore kërkon jo vetëm fuqi punëtore të aftë dhe sundim të ligjit, por edhe rol aktiv të shtetit në adresimin e shtrembërimeve të tregut dhe në ofrimin e shërbimeve lehtësuese dhe favorizuese, sidomos kur bëhet fjalë për sektorët strategjik.

Kosova ka interes që të stimulojë kalimin e ekonomisë në aktivitete me vlerë të shtuar më të lartë dhe në prodhime të tregëtueshme, sepse vetëm ky hap cilësor do të mund t'i rrisë të ardhurat në ekonomi. Deri më sot, bizneset dhe industritë në Kosovë kanë lindur dhe janë rritur pa rolin aktiv të shtetit, ndërkohë që mekanizmat institucionalë të mbështetjes, si edhe investimet në asete strategjike industriale, kanë qenë të kufizuara.

1.2 Objektivi i punimit dhe hipotezat e punimit

Objektivi i këtij punimi është studimi i efekteve dhe faktorëve që ndikojnë në investimet e huaja në Kosovë si dhe studimi i tregueseve të efektshmërisë të investimeve bazuar në avantazhet dhe disavantazhet e sistemit ekonomik dhe zhvillimit të proceseve ekonomike në Kosovë. Për të bërë këtë studimi, natyrisht do shqyrtohet situata globale duke krahasuar efektet dhe faktorët të cilët ndikojnë në investimet në regjion, pra, shteteve në tranzicion dhe shteteve të cilët janë anëtarët të BE-së.

2. Modeli teorik i punimit

2.1 Investimet huaja dhe akumulimi i investimeve të huaja

Nëse marrim në konsideratë që investimet janë faktori kyç në zhvillimin ekonomik, atëherë duhet të pranohet se efikasiteti ekonomik varet prej shkalles së investimeve në një vend. Me efektivitet të investimeve, nënkuptojmë lidhjen në mes të kapitalit pra fondeve materiale bazë dhe prodhimin. Në anën tjetër mund të

=====

kuptohet edhe si relacion në mes të konsumit të kapitalit dhe efektit ekonomik të investimeve. Për të matur efikasitetin ekonomik të investimeve përdoret koeficienti i efikasitetit.

Investimet paraqesin një kategori komplekse e cila është në një farë mënyre e lidhur me akumulimin. Prandaj, është e nevojshme të bëhet dallimi ndërmjet akumulimit dhe investimeve për të kuptuar më mirë konceptin e investimeve dhe lidhjen e akumulimit me investimet.

Ekziston një pajtim i përgjithshëm në literaturë se investimet e huaja direkte janë një segment shumë i rëndësishëm për ekonominë e vendit, sepse efektet që dalin nga akumulimi e IHD janë të mëdha dhe ndikojnë në rritjen ekonomike e të një vendi.

Për të kuptuar më mirë rëndësinë e investimeve të huaja në Kosovë do të duhet të shqyrtohet së pari pjesa e cila ka të bëjë me kuptimin teorikë të definimit të investimeve të huaja.

Prandaj sipas N.Kordić (2012) me investime të huaja direkte, nënkuptojmë një formë të lëvizjeve ndërkombëtare të kapitalit, fillon nga konceptet e transaksioneve ekonomike dhe transaksionet ekonomike ndërkombëtare.

Transaksioni ekonomik është vlera e shkëmbimit ku ka një ndryshim të pronësisë së mallrave dhe shërbimeve të caktuara me pretendimet financiare. Nëse ky shkëmbim është realizuar në mes të banorëve të vendeve të ndryshme, ky quhet transaksion ekonomik ndërkombëtar.

Ekonomia kombëtare realizohet nëpërmjet marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare sipas kategorive të mëposhtme:

- 1) eksporti dhe importi i mallrave dhe shërbimeve;
- 2) eksportin dhe importin e kapitalit;
- 3) transfere të njëanshme;

Në anën tjetër OCDE (2007) investimet e huaja i përkufizon si:

synim i sigurimit të një interesi të qëndrueshëm të një njësie rezidente në një ekonomi (investuesi direkt), në një njësi rezidente të një ekonomie tjetër (ndërmarrja e investimit direkt).

Në përgjithësi, akumulimi është një kategori e cila bën shpërndarjen e produktit shoqëror dhe të ardhurat kombëtare. Zhvillimi socio-ekonomik i një shtetit bazohet në akumulimin e investimeve dhe ky është një parakusht themelor e zhvillimit ekonomik.

Duke pasur parasysh se akumulimi është kategori e produktit shoqëror dhe i të ardhurave kombëtare, mund të thuhet se me rritjen e produktit shoqëror dhe të ardhurave kombëtare krijohet parakushti për arritjen e niveleve të larta të akumulimit të investimeve.

=====

Akumulimi po ashtu është kategori e cila dedikohet në shpërndarjen e produktit shoqëror të të ardhurave kombëtare dhe paraqet në fakt një faktor të riprodhimit dhe është pjesë e të ardhurave kombëtare i përkushtuar riprodhim më të lartë. Gjithashtu, akumulimi mundëson rritjen e kapitalit të kompanisë e cila ka vendosur zhvillojë biznesin mbështetur në investime të reja.

Në këtë drejtim, është e nevojshme të bëhet dallimi midis akumulimit (real) dhe akumulimin të parasë. Akumulimi *cash* përfaqëson një pjesë të veçantë të të ardhurave kombëtare për riprodhim të zgjeruar dhe konsumin e tij. Përdorimi i akumulimit cash paraqet akumulimin aktual (të vërtetë). Akumulimi Cash duhet t'i paraprijë akumulimit aktual (dedikuar për përfitimin e një pjesë të të ardhurave kombëtare për riprodhim të zgjeruar). Megjithatë, në praktikë kjo nuk është gjithmonë kështu.

2.2 Vlera dhe ndikimi i investimet e huaja direkte në Kosovë

Në Kosovë bazuar në indeksin kohor të 2010-2015 kemi një mesatare prej 220 milionë euro për një vit të investimeve të huaja. Trendi i investimeve të huaja në Kosovë viteve të fundit tregon rënie të vazhdueshme (shiko fig.1). Natyrisht shumë faktorë ndikojnë në trendin e rënies e IHD, filluar nga faktorët e politikës globale deri të faktorët e kushteve të zhvillimit të proceseve ekonomike në vend. Faktorët bazuar në kushtet politike globale që ndikojnë në vlerën e investime të huaja në vitet e fundit burojnë me së shumti nga krizat financiare globale.



Burimi BQK 2015, Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike Numër 3 fq.43

Investimet e huaja direkte (IHD) janë vendimtare për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e vendit, në veçanti për një ekonomi të vogël që ende nuk ka arritur standardet teknologjike botërore. Pas fillimit të krizës globale financiare në vitin

=====

2008 dhe shkurtimeve të mprehta të IHD, në shumicën e ekonomive të Ballkanit Perëndimor, vetëm në vitin 2011 është konstatuar një rritje modeste e IHD (shih Figurën 1.9).

Problematikë tjetër e investimeve siç është cekur në modelin teorik të këtij punimit është alokimi i IHD. P.sh. investimet në Kosovë deri me tani kanë qenë kryesisht në sektorin e shërbimeve financiare, që mesatarisht kanë marrë 36% të totalit të IHD-së gjatë viteve 2007-2015.

Në vitet 2010-15, një e treta e totalit të investimeve shkoi në pasuri të patundshme dhe ndërtim, dhe një e pesta në shërbimet financiare (Komisioni Evropian, 2015).Sektori i prodhimit kohët e fundit ka shënuar një rritje të konsiderueshme në IHD. Gjatë viteve 2010 deri 2015 ai ka pranuar pjesën më të lartë të IHD me 22.5%, krahasuar me vetëm 6% të totalit me vitet mëherëshme. Megjithatë, kjo rritje e IHD në sektorin e prodhimit është e lidhur kryesisht me privatizimin më tepër se fusha e gjelbër e investimeve të reja (KPMG, 2014).

Tabela nr 2 Portfolio tanishëm e investimeve në Kosovë 2003-2015

Portfolio tanishëm e investimeve në Kosovë	Në mil
Energji	69,02
Institute financiare	54,74
Industri biznesore dhe agrobiznes	33,32
Infrastrukturë	80,92
	238

Burimi: BERZH, Raporti për Kosovë 2015

Bazuar në tabelën 2 mund të konstatohet se portfolio apo fondet e IHD në Kosovë në vitin 2014 kanë qenë 238 mil euro. Një pjesë e vogël është investuar në industrinë bujqësore dhe agrobiznes vetëm 8,4% në total, gjë që tregon pakujdesi në përzgjedhjen e prioriteteve të zhvillimit ekonomik në vend, sepse ekonomia e Kosovës ka nevojë për zhvillimin e sektorit të prodhimitarisë dhe zvogëlimin e bilancin negativ tregtar. Mbase problemi qëndron tek shtetet të cilat më së shumti investojnë në vendin tonë dhe bëjnë përzgjedhjen e investimeve në Kosovë.

Bazuar në të dhënat e vitit 2015 shtetet të cilat më së shumti kanë investuar në Kosovë janë: Zvicra, Turqia dhe Mbretëria e bashkuar . Për më shumë informata në lidhje me shtetet të cilat kanë investuar në Kosovë në vitin 2015 mund të shikoni tabelën në vijim.

=====

Tabela nr 3. Shtetet me pjesëmarrjen me të madhe të IHD në Kosovë 2015

Shteti	Vlera mil.€
Zvicra	70,3
Turqia	54,1
Mbretëria e Bashkuar	34,8
Shqipëria	34,6
Gjermania	29
Austria	28,1
Slovenia	26,5
SHBA	22,5
Italia	5,3
Total	305,2

Burimi: Përpunuar nga raporti investimeve në Kosovë 2015 AIK 2015

Përveç konstatimit se sa investojnë shtete e huaja në Kosovë, tabela e mësipërme tregon vleren ulët e investimeve 305,2 milionë euro në relacion me BPV vendorë. Nëse bëjmë një krahasim me shtetet e tjera vetëm 5 % vlerës e bruto të produktit vendor (BPV) janë investime të huaja.


3. Analiza dhe diskutimi i rezultateve

3.1 Kushtet ndikuese të investimeve të huaja në Kosovë

Në këtë pjesë do të bëhet diskutimi në lidhje me faktorët e brendshëm të cilët ndikojnë në nivelin e IHD në Kosovë.

Një prej kushteve në kryerjen e investimeve në një shtet është mjedisi biznesor, në të cilin bëjnë pjesë sundimi i ligjit, stabiliteti ekonomik politik etj. Po ashtu një element shumë i rëndësishëm në marrjen e vendimeve për të investuar është edhe përcaktimi i lokacionit të investimeve. Në bazë të hulumtimit e organizatë IFC në vitin 2014 del që mesatarisht 60% e të anketuarëve konsiderohet të jetë faktori i përcaktimit të lokacionit në vendimin e bërjes së investimeve.

Figura 3 Rëndësia e faktorëve të lehtësimit të biznesit Për investorët aktualë dhe potencialë



Burmi: Baza e te dhënave të punimit 2016

3.2 Kushtet e tregut në relacion me investimet e huaja në Kosovë

Duhet të theksohet se rëndësia e faktorëve të tregut që ndikojnë në vendimin për të investuar apo jo, është mjaft e ndryshme për investorët aktualë dhe ata potencialë. Për investorët aktual, niveli i konkurrencës dhe disponueshmëria e tregut lokal janë raportuar si faktori më i rëndësishëm në përcaktimin e lokacionit të investimeve me 62.7% dhe 61.8% respektivisht që e kanë vlerësuar si faktor “vendimtar”. Faktorë të rëndësishëm gjithashtu duket të jenë prania e klientëve kryesorë dhe qasja lokale në financim për të cilat 54.5% dhe 50.8% e të anketuarve i konsiderojnë ato si vendimtare.

Tabela nr 3.Përceptimi i investorëve potencial

	Rëndësi e ulët (%)	Neutrale (%)	Rëndësi e lartë (%)
Disponueshmëria e fuqisë punëtore të kualifikuar	4	11	85
Kostoja e fuqisë punëtore	6	19	75
Disponueshmëria e lëndës së parë	7	22	71
Furnizuesit	5	37	58

Burmi: Baza e te dhënave të punimit 2016

Përfundimi

Investimet qoftë të huaja apo vendore sjellin efekte pozitive në rritjen ekonomike në një vend. Këto efekte mund të vërehen kudo në industri dhe parë nga aspekti ekonomik këto efekte mund të studjohen në mjedisin mikro dhe makroekonomik.

Fluksi i investimeve të huaja direkte në Kosovë, përgjithësisht ka pasur rritje mirëpo ende është në nivel të ulët bazuar në pjesërrjen e tyre në BPV përkatësisht vetëm me 5 % të investimeve të huaja në vend, nëse shikohet nga trendi i periudhës kohore 2003-2015.

Siç vërehet në punim niveli investimeve varet nga liritë ekonomike, konkretisht ngar liritë bazë ekonomike. Vëmëndje të vecantë për Kosovë zë liria në të bërit biznes dhe lehtësitë që u janë krijuar bizneseve me kapital të huaj dhe vendas njëkohësisht. Problem në këtë kuadër mbetet mjedisi jo i përshtatëshem për të investuar në Kosovë sepse problemi me i madh është zbatimi i ligjeve që kanë të bëjnë me ruajtjen e pronësisë dhe kapitalit të investitoërve.

Literatura